

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Klllokot-Verbovci/Opština Klokot-Vrbovac/Municipality of Klokot-Vrbovac

Në bazë të nenit: 12. paragrafi 12.2.; neni 17. paragrafi (b, c, d.); Ligjit për vetqeverisje lokale nr. 03/L-040, neni: 19. Paragrafi 2. Ligjit mbi ndërtimin nr:04/L-110, neni: 6. Paragrafi 1.2 nënparagrafi 1.2.1; 1.2.2.; Ligjit mbi planifikimin hapsinor nr: 04/L-174; neni:10. paragrafi 10.1; 10.5; pika (a) ; neni 11. Paragrafi 11.4 Ligjit mbi tokën bujqësore nr: 02/L—26, si dhe nenit : 8. Paragrafi 8.1. (b,c,d) nenit 13. pika (I) statutit të komunës së Klllokot-Vërbovcit . Kuvendi komunal merr :

Vendim mbi mbrojtjen e tokave bujqësore

I.

Kuvendi komunal i Klllokot – Vërbovcit në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit e mbajtur me datën : 30.04.2018 merr vendim mbi mbrojtjen e tokave bujqësore.

II.

Delegatët për vendimin në titullin e lartëshënuar votuan : 12 PËR; Kundër nuk pati, ndërsa 3 delegat nuk u deklaruan. Kuvendi komunal me këtë vendim në titull nga ligjet e lartëcekura ndalon ndryshimin e përdorimit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore nga klasa 1 deri në 4 për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët janë pronar të ngastrave, nga ana e djathtë dhe e majtë të të gjitha rrugëve në teritorin e komunës tonë.

III.

Nga legjislacioni i lartpërmendur në fuqi, është vërtetuar se niveli lokal si komuna, gjegjësisht Kuvendi komunal si organi më i lartë i legjislacionit të vetqeverisjes lokale me fuqi ekzekutive, të cilat zbatojnë reciprokisht të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë për çështjet e planifikimit hapësinor, kushtet për ndërtimin e objekteve përgjatë rrugëve të përmendura në pikën 4. ekziston ndalimi në fuqi për ndërtim të mëtejshëm dhe ndryshimi i destinacionit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore dhe të gjitha punët që janë me interes për komunën dhe ndërtimet e tjera mund të merren me miratim të veçantë nga kryetari i komunës me miratimin e kuvendit të komunës. Një ndalim i tillë do të mbetet në fuqi derisa të prodhohen dokumentet strategjike komunale, siç janë Plani Hapësinor, Plani Urbanistik dhe Plani Zhvillimor Komunal, me anë të të cilave një tokë e tillë i është caktuar një qëllim tjetër sipas ligjit.

IV.

Ndalohet ndërtimi i çfarodo lloji objekti në tokat që janë në komosacion. Në masën e tokës nën komosacion janë të përfshira zonat kadastrale Grncari, Vërbovci dhe Mogilla kjo është arsyeja për cka ndalohet ndryshimi i përdorimit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore nga klasa 1 deri në 4 në teritorin e komunës , deri në ndërtimin e një kadastrë të re me regjistrimin e parcelave në komosacion. Në zonën kadastrale në Klllokot ka ekzistuar Plani zhvillimor Urbanistik nga 2012-2017+ për të cilit është marrë vendimi i Kuvendit nr. 2929/2 me datën 28.12.2012. Është e nevojshme të bëhen ndryshime në këtë plan nga ekspertët dhe të vazhdojnë të punohet sipas tij. Plani Zhvillimor Urban për zonën kadastrale të Klllokotit aktualisht vënë në pushim deri në një njoftim të mëtejshëm.

Ngastrat të cilat gjinden për rreth rrugëve nga ana e djathtë dhe e majtë në teritoritn e komunës sic janë:

1. Rruga në hyrje të Mogillës nga drejtimi i Kllokotit në anën e majtë dhe të djathtë të klasave III-IV të tokës bujqësore zona kadastrale Mogillë
2. Rruga në dalje në drejtim të Vitina në Mogillë nga drejtimi i Kllokotit në anën e majtë dhe të djathtë të klasës IV të tokës bujqësore zona kadastrale Mogillë.
3. Rruga në dalje nga Mogilla drejt Vrbovcit në anën e majtë dhe të djathtë të klasës së II të tokës bujqësore zona kadastrale Mogillë.
4. Rruga në hyrje të Vrbovcit nga drejtimi i Mogillës në anën e majtë dhe të djathtë të klasës së II të tokës bujqësore zona kadastrale Vërbovc.
5. Rruga në dalje të Vërbovcit drejt Letnicës në anën e majtë të klasës IV dhe në anën e djathtë të klasës IV të tokës bujqësore zona kadastrale Vërbovc dhe Grncar.
6. Rruga në dalje të Vrbovcit drejt Podgorcit në anën e majtë të klasës II dhe në anën e djathtë të klasës IV të tokës bujqësore zona kadastrale Vërbovc.
7. Rruga në dalje të Vrbovcit drejt Ramnishtës nga e majta e klasës së III dhe në anën e djathtë të klasës III-IV të tokës bujqësore zona kadastrale Vërbovc.
8. Rruga në dalje Vrbovec drejt Gjylekreshtës në anën e majtë të klasës II-III dhe në anën e djathtë të klasës III-IV të tokës bujqësore zona kadastrale Vërbovc dhe Grncar.
9. Rruga në dalje nga Grnçar deri te kthesa e rrugës Vërbovc-Gjylekresht në të majtë të II-IV dhe në anën e djathtë të klasës III-V të tokës bujqësore zona kadastrale Grncar.
10. Rruga në të majtë përgjatë rrugës kryesore Gjilan - Ferizaj, nga Kllokoti përmes Pozharanit dhe nga Kllokoti përmes Radivojcit zona kadastrale Kllokot;
11. Rruga drejt Trpezes nga e majta dhe e djathtë e Kllokotit deri ne kufirin e komunes me Viti zona kadastrale Kllokot;
12. Rruga nga e majta dhe e djathta e rugës kryesore Kllokot-Viti përreth pompës së benzinës ,, Tafa-petrol,, deri tek kufiuri i teritorit të komunës zona kadastrale Kllokot;
13. Rruga nga e majta dhe djathtas përgjatë rrugës Kllokot-Zhiti deri në kufirin e territorit të komunës zona kadastrale Kllokot.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetarti i komunës dhe drejtoria kompetente për bujqësi,pylltari dhe hidroekonomi si dhe drejtoria për kadastër,urbanizëm dhe gjeodezi.


V.

Ky vendim nga neni 1. Hyn në fuqi menjher pas nënshkrimit të saj nga ana e kryesuesit të kuvendit komunal Kllokot-Vërbovc dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria kompetente për qevberisje lokale,ndërsa validiteti i saj është i mëtejshëm deri në ndryshim apo plotësim në Kuvend.

Dorëzohet:

- MAPL
- Kabinetit të kryetarit
- Kuvendit komunal
- Arkivës

Kryesuesi i kuvendit komunal
Kllokot-Vërbovc


Žarko Dejanović



Datë :30.04.2018